

VENDIM
Nr. 269, datë 12.5.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 94, DATË 4.2.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT PËR ARMËT NË RASTET E DEKLARIMIT TË VDEKJES, DEKLARIMIT TË MBYLLJES LIGJORE TË AKTIVITETIT, PËR QËLLIME STUDIMORE, TË HUMBJES SË ARMËS, VJEDHJES SË SAJ APO DOKUMENTIT/AUTORIZIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 44, të ligjit nr. 74/2014, datë 10.7.2014, "Për armët", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 94, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në kreun I bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Në rast vdekjeje të pronarit të armës, një pjesëtar madhor i familjes së tij ose përfaqësuesi i tij ligjor, kujdestari i të miturit apo personit që i është hequr zotësia apo ka zotësi të kufizuar, personi që ka jetuar me të në të njëjtën banesë ose personi tek i cili gjendej arma në momentin e vdekjes, si edhe çdo person që ka dijeni për ekzistencën e një arme në pronësi të personit të vdekur është i detyruar që, brenda 10 (dhjetë) ditëve, të njoftojë *online* në Portalin Unik Qeveritar *e-Albania* ose strukturën vendore të policisë ku janë regjistruar armët, nëse dihet, ose strukturën e policisë ku ka vendbanimin personi që ka humbur jetën."

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Armët, pjesët përbërëse të tyre, tërhiqen nga punonjësi i policisë së njësisë ku janë regjistruar dhe merren në ruajtje, në pritje të trashëgimitarit për t'i marrë e regjistruar në pronësi. Në momentin e dorëzimit të tyre organi përgjegjës për armën dhe municionin e dorëzuar pajis dorëzuesin me një vërtetim."

c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Trashëgimtari i vetëm i armës, pjesëve përbërëse të saj, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga momenti i pranimit të trashëgimisë apo i përfundimit të afateve për heqjen dorë nga trashëgimia, si dhe kujdestari ligjor i trashëgimitarit, të cilit i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar, me vendim gjyqësor detyrohet të kryejë një nga veprimet e mëposhtme:

a) të tjetërsojë armën, pjesët përbërëse të saj dhe municionin; ose

b) të paraqesë kërkesë për pajisjen me autorizim për "mbajtje arme"; ose

c) të dorëzojë armën për ta çaktivizuar; ose

ç) t'ia dorëzojë armën, pjesët përbërëse të saj dhe municionin, Drejtorisë Vendore të Policisë ku ka vendbanimin, pa asnjë kundërshpërblim."

ç) Pas pikës 3 shtohen nënpikat 3.1, 3.2, 3.3, 3.4 dhe 3.5, me këtë përmbajtje:

"3.1 Në rast se trashëgimtari i armës dhe municionit është i mitur, arma, pjesët e tyre dhe municioni do të qëndrojnë në ruajtje pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit deri sa i mituri të arrijë moshën për t'u pajisur me autorizim për armë. Trashëgimtari i armës, me arritjen e moshës 25 vjeç, është i detyruar që të veprojë sipas përcaktimeve në pikën 3, shkronjat "a", "b", "c", "ç", të këtij vendimi.

3.2 Kur trashëgimtari i armës e tjetërson atë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shitjes, detyrohet ta çregjistrojë armën në fjalë nga regjistri i armëve, pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit.

3.3 Kur trashëgimtari i armës paraqet kërkesë për pajisjen me autorizim "mbajtje arme", organi përgjegjës i Policisë së Shtetit e pajis me autorizimin përkatës nëse përmbush kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas ligjit nr. 74/2014, "Për armët", të ndryshuar.

3.4 Nëse trashëgimtari i armës dëshiron ta mbajë atë si relike, duhet ta çaktivizojë atë në mënyrë të përhershme dhe, brenda 5 (pesë) ditëve, ta çregjistrojë pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit. Shpenzimet e çaktivizimit të armës mbulohen nga kërkuesi.

3.5 Arma, që trashëgimtari i dorëzon Drejtorisë Vendore të Policisë ku ka vendbanimin, pa asnjë kundërshtim, çregjistrohet nga regjistri i armëve pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit.”.

2. Pika 5, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Subjekti, me mbylljen ligjore të aktivitetit, bën njoftimin *online* për strukturën e Policisë së Shtetit, e cila me marrjen dijeni nga subjekti dhe në prezencë të tij bën menjëherë, por jo më vonë se 24 orë nga marrja dijeni, bllokimin e armëve të lejuara, së bashku me municionet e tyre, kundrejt procesverbalit përkatës, ku një kopje e tij i jepet të interesuarit.”.

3. Në kreun IV bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në fund të pikës 14, shtohen fjalët “... ose *online* në Portalin Unik Qeveritar *e-Albania*.”.

b) Në fund të pikës 17 shtohen fjalët “... ose *online* në Portalin Unik Qeveritar *e-Albania*.”

II. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe